



SHERBIMI SOCIAL

#FESTAT DUAN DASHURI



Ky fundvit ka qenë i mbushur me festa dhe aktivitete në të gjitha institucionet tona të përkujdesit. Atmosfera festive ka nisur me vendosjen e pemës nga vetë përfituesit në të gjitha institucionet tona.

Me mbështetjen e miqve tanë të Shërbimit Social kemi realizuar aktivitete festive me animatorë dhe si gjithmonë babagjyshi ka sjellë thesin e madh të dhuratave për të gjithë fëmijët dhe të moshuarit!

#FESTË EDHE PËR FËMIJËT E PREKUR NGA TËRMETI



Në të gjitha kampet ku janë vendosur familjet e prekura nga tërmeti Shërbimi Social Shtetëror përveç mbështetjes psiko-sociale dhe mbështetjes me pako ushqimore, ka organizuar festat e fundvitit për të gjithë fëmijët.

Ky fundvit duhet të ishte i bukur për të gjithë, ndaj ne u angazhuam në zbulimin e festave të fundvitit për të gjithë fëmijët duke i dhuruar secilit prej tyre nga një pako të madhe dhuratash.



SHERBIMI SOCIAL

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Gjatë muajit Dhjetor 2019 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka realizuar dhe dërguar raportin e kontrollit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan.

Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark. Është monitoruar procesi i mbledhjes së Këshillave Bashkiakë për marrjen e vendimeve, si edhe monitorimi i kontrolleve të kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin Dhjetor.



#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Dhjetor 2019, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 4 raste VT/VMT.

Është mbledhur Komisioni për Fëmijët, ku pas shqyrtimit të dokumentacionit janë pranuar 2 fëmijë në IPSH.

Është mbledhur Komisioni për të Moshuarit, ku janë shqyrtuar 15 raste. Janë sistemuar në IPSH 3 prej tyre, është transferuar 1 rast dhe janë refuzuar 11 prej kërkesave.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, janë pajisur me Status të Jetimit 16 raste të reja dhe janë kryer 4 rinovime.





SHERBIMI SOCIAL

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR

Ka ardhur babagyshi dhe elfët në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”

Ne nuk pritëm ditën e fundit të vitit për të festuar. Me miqtë e Shërbimit Social Shtetëror organizuam një aktivitet festiv me koktejl dhe animatorë. Babagyshi nuk e harroi thesin e dhuratave as këtë vit!

Mirënjohje për miqtë tanë që këtë fundvit vendosën të bënin më të bukura festat e fëmijëve të familjes sonë të Zyber Hallullit!

